

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ INVICTUS LLC” Sh.p.k.**

**KAPITULLI I
EMRI, FORMA E SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI, KOHËZGJATJA**

Në Tiranë, sot më 16.06.2025, në përputje me nenin 230 të Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në cilësinë e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë:

“**Marina Bay**” Sh.p.k, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT, L97426202U në datën 26/12/2019 në formën ligjore Sh.p.k., e themeluar më datë 19/12/2020 me përfaqësues ligjor Znj. Anxhela Lulaj, e datëlindjes 03/06/1998, lindur në Vlorë, titullar i ID me nr. J85603070R, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, bazuar në vendimet e tyre të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. ____ datë 15.06.2025 themelon Shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “INVICTUS LLC” Sh.p.k.

Neni 1

Themelimi

- 1.1 Emri i shoqërisë është “**INVICTUS LLC**” Sh.p.k. (këtu më poshtë e quajtur “**Shoqëria**”). Shoqëria është themeluar në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 1.2 Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- 1.3 Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Statutin.

Neni 2

Selia

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr. Ismail Qemali, Pallati nr.34, Kati i 2-të, Ap.9, Tiranë, Shqipëri.
- 2.2 Shoqëria mund të themelojë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe/ose në shtete të tjerë, në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe Statutin, vetëm me Vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë.

Neni 3

Objekti



3.1 Objekti kryesor i Shoqërisë do të jetë:

- Zhvillimi i veprimtarive tregtare, industriale, shërbimeve dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga ligji, përfshirë por pa u kufizuar në:
 - Tregti me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale, ushqimore, ndërtimore dhe elektroshtëpiake, brenda dhe jashtë vendit;
 - Import-eksport i mallrave të ndryshme të ligjshme;
 - Shërbime marketingu, konsulence, menaxhimi, auditimi, kontabiliteti dhe teknologjie informacioni (IT);
 - Ndërtim dhe rikonstrukcion objekteve civile, industriale, infrastrukturore, dhe mirëmbajtje të tyre;
 - Transport mallrash dhe udhëtarësh brenda dhe jashtë vendit;
 - Veprimtari në fushën e turizmit, agroturizmit dhe hotelierisë;
 - Aktivitet në fushën e arsimit joformal dhe trajnimeve profesionale;
 - Marrje me qira ose dhënie me qira të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme;
 - Investime në pasuri të paluajtshme dhe zhvillim pronash për qëllime tregtare ose turistike;
 - Çdo veprimtari tjetër e ligjshme që i shërben qëllimeve të shoqërisë;
 - Menaxhim restorantesh, baresh dhe aktiviteteve si dhe organizim eventesh.
 - Katering;
 - Menaxhim dhe administrim të bizneseve, projekteve, aseteve dhe pasurive të ndryshme;
 - Ofrim shërbimesh konsulence për menaxhimin strategjik, organizativ, financiar, burimeve njerëzore dhe operacioneve;
 - Menaxhim i pronave të paluajtshme dhe të luajtshme, përfshirë mirëmbajtje, zhvillim dhe dhënie me qira;
 - Menaxhim dhe koordinim i aktiviteteve në fushën e turizmit, hotelierisë, restoranteve dhe agroturizmit;
 - Trajnime dhe zhvillim profesional në fushën e menaxhimit dhe administrimit;
 - Çdo aktivitet tjetër të ligjshëm që i shërben qëllimeve të mësipërme.

Në funksion të objektit kryesor të parashikuar më sipër, Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë gjithashtu aktivitetet e mëposhtme:

- themelimin e sipërmarrjeve të përbashkëta ose ortakërive me palë të treta;
- shit-blerjen e kuotave dhe aksioneve në shoqëri të tjera;
- marrjen ose dhënien e huave;
- vendosjen e hipotekave, pengjeve ose garancive të tjera;
- çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar.

3.2 Kryerja e aktiviteteve, për të cilat nevojiten lejet dhe/ose miratimet përkatëse, do të bëhet pas marrjes së këtyre lejeve dhe/ose miratimeve.



Kohëzgjatja

- 4.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një periudhë të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, KUOTAT

Neni 5

Kapitali Themeltar dhe Ortakët

- 5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100 (njëqind) Lek.
Ortaku i vetëm i Shoqërisë është:
- “Marina Bay” Sh.p.k**, person juridik shqiptar, i regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT, L97426202U në datën 26/12/2019 në formën ligjore Sh.p.k., e themeluar më datë 19/12/2020 me përfaqësues ligjor Znj. Anxhela Lulaj;
- 5.2 Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para me themelimin e Shoqërisë nga Ortaku i vetëm i shoqërisë **“Marina Bay” Sh.p.k**, me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) lekë, të cilat përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 5.3 Kontributi i Ortakut të Vetëm të Shoqërisë mund të jetë në natyrë (pasuri të paluajtshme apo të drejta) ose në para.
- 5.4 Përgjegjësia e Ortakut të vetëm shtrihet deri në shumën e kontributit të tij në kapitalin themeltar. ***Pra, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë përgjigjet për humbjet e shoqërisë kundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.***

Neni 6

Transferimi i Kuotave

- 6.1 Ortaku i vetëm i shoqërisë mund të transferojë kuotën e tij në kapitalin e Shoqërisë çdo pale të tretë.

Neni 7

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i kapitalit

- 7.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe në shërbime

nëpërmjet emërimit të një eksperti të autorizuar për këto kontribute në natyrë sipas kërkesës së administratorit.

- 7.2 Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut të Vetëm me të njëjtat kushte që kërkojnë për ndryshimin e Statutit.
- 7.3 Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratori, në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar.

Neni 8

Transferimi i Kapitalit

- 8.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
- Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
 - Shitblerjes;
 - Trashëgimisë;
 - Dhurimit;
 - Cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligji.
- 8.2 Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontratat duhet të bëhen me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga casti i kalimit të kuotave, deri në castinregjistrimit të kalimit të tij në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sipas nenit 43 të Ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”. Regjistrimi i klaimit të kuotave ka efekt deklarativ.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 9

Organi i Vendimmarrjes

- 9.1 Ortaku i vetëm është organi vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas rregullave të përcaktuara në legjislacion. Çdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pasqyruar në skedën e shoqërisë.
- 9.2 Ortaku i vetëm vendos për çështje si:
- Përcakton politikat tregtare të shoqërisë;
 - Emëron dhe shkarkon administratorët;
 - Emëron dhe shkarkon likuiduesit dhe ekspertët kontabël të autorizuar, për përcaktimin e shpërblimeve të tyre;
 - Mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e

- pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) Përfaqëson shoqërinë në gjykatë dhe në procedurat e tjera ndaj administratorëve;
- f) Miraton rregullat procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
- b. Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në regjistrin real të vendimeve, dhe të dhënat e këtij regjistri nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet të regjistrohen veçanërisht, ndër të tjera, vendimet për:
- a) Pasqyrat financiare vjetore dhe raportet e ecursisë së veprimtarisë;
 - b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investimet;
 - ç) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

9.3 Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundërvihet pavlefshmërisë së një akti që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rasteve kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10


Administrimi

- 10.1** Administrator i shoqërisë është **znj. Florenta Ismali**, shtetase Kosovare, lindur në Kosovë më 21.04.2023 dhe banuese në Tiranë, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. J08421003F;
- 10.2** Administratori i shoqërisë do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 1-(një) vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje, nga data 16.06.2025 deri më datë 15.06.2026.
- 10.3** Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm të shoqërisë. Administrator i shoqërisë mund të emërohet edhe një person i tretë jashtë ortakërisë.

Neni 11

Kompetencat

- 11.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrim që:
- a. Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga ortakut i vetëm;
 - b. Të përfaqësojë shoqërinë në tregti;
 - c. Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;



- d. Të përpilojë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, si dhe bashkë me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'ia paraqesë këto dokumente asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e. Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohë për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f. Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- g. Të raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

12.2 Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim, ose kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të përfshijë një ortak me pasuri që ka vlerë më të lartë se 5% e aseteve të shoqërisë, sipas pasqyrës së fundit financiare të certifikuar.

12.3 Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm. Ai përfaqëson shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë dhe juridikë, publikë dhe privatë, vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore shqiptare apo të huaja, përfshirë edhe autoritetet bankare të të gjitha niveleve.

12.4 Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat, përveç atyre kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë.

Neni 13

Përgjegjësitë

13.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

13.2 Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga ortaku i vetëm, që sjellin dëm për shoqërinë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka miratuar marrëveshjen, për t'i përballuar në mënyrë individuale ose solidare, sipas rastit, pasojat përkatëse.

13.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 4, 15, 17 dhe 18 të ligjit "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**", administratori detyrohet:

- a. Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut, me mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

- b. Të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e objektivave të përcaktuara në këto dispozita;
 - c. Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
 - d. Të parandalojë dhe të shmangë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë;
 - e. Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.
- 13.4** Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim që bëhet në mënyrë të paarsyeshme në dëm të shoqërisë tregtare, përjashtuar rastet kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 13.5** Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai ose personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta.
- 13.6** Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt dhe sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 13.7** Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar vetëm në to, administratori është i detyruar të dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "**Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare**", kryen veprimet e mëposhtme:
- a. Nuk kërkon nga ortakët përmbushjen e kontributeve të tyre;
 - b. U paguan ortakëve interesa apo dividendë në mënyrë të parregullt;
 - c. U shpërndan ortakëve aktive të shoqërisë në kundërshtim me ligjin;
 - d. Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të ishte parashikuar që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
 - e. Jep kredi në mënyrë të kundërligjshme.

Neni 14

Viti Financiar

- 14.1** Viti financiar fillon në 1 Janar dhe përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti kalendarik. Në përfundim të vitit kalendarik Administratori harton pasqyrat financiare të Shoqërisë në përputhje me ligjet në fuqi.
- 14.2** Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2025.



Neni 15

Fitimi i shoqërisë dhe dividendët

- 15.1** Brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit financiar, mbledhja e ortakut të vetëm miraton bilancin e paraqitur nga administratori. Mbledhja e ortakut të vetëm vendos mbi shpërndarjen e dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar dhe të jenë bërë parashikimet e nevojshme sipas ligjit.

Neni 16

Ekspertët

- 16.1** Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë me autorizim nga akti i ortakut të vetëm.
- 16.2** Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor, si dhe për ato të kontrollit periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar t'ia dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar dhe miratuar, mbi bazën e të drejtës vendimmarrëse që ka.

Neni 17

Të ardhurat neto (Dividenti)

- 17.1** Të ardhurat neto që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të sipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi ortakut të vetëm të shoqërisë.

Neni 18

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë

- 18.1** Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:
- a. Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
 - b. Me vendim të ortakut të vetëm;
 - c. Me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d. Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
 - e. Me vendim të gjykatës.



- 18.2** Në këtë rast, ortakut i vetëm merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidues dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe mbishkrimin shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.
- 18.3** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendje të aftësisë pague, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakut i vetëm. Nëse ortakut i vetëm nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

Neni 19

Likuiduesi

- 19.1** Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit nga data e emërimit të tij.
- 19.2** Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveç kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat dhe detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.
- 19.3** Veprimet dhe kontratat e likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit. Likuiduesi i nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakut dhe administratorit.

Neni 20

Të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit

- 20.1** Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e preferencës, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
- 20.2** Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e rregullt të veprimtarive të papërfunduara.
- 20.3** Në rast të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, likuiduesi përfaqëson shoqërinë në gjykatë dhe përmbush detyrimet që rrjedhin prej saj.

Nëse likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, detyrohen ta pezullojnë procesin e likuidimit dhe të kërkojnë nga gjykata përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit. Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përmbyllës në fazën e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit gjithashtu pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëritë kolektive dhe komandonde miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo ato me përgjegjësi të kufizuar, miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 21

Përfundimi i likuidimit

21.1 Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 22

Bashkimi

22.1 Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

- a. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen **shoqëri të përthithura**, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur **shoqëri përthithëse**, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet **bashkim me përthithje**.
- b. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet dhe pasivet e shoqërive ekzistuese që bashkohen, në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet **bashkim me krijimin e një shoqërie të re**.

Neni 23

Ndarja

- 23.1** Një shoqëri mund të ndahet me vendim të ortakut të vetëm, duke transferuar të gjitha aktivet dhe pasivet e veta në favor të dy ose më shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet vlerësohet si e prishur.
- 23.2** Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008.

- 23.3** Shoqëritë që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet quhen **shoqëri pritëse** dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
- 23.4** Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sjell si pasojë:
- a. kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve dhe pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
 - b. prishjen e shoqërisë që ndahet dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, pa kryerjen e likuidimit;
 - c. bëhen aksionarë apo ortakë të shoqërive pritëse të njëjtët aksionarë apo ortakë të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes.

Neni 24

Shndërrimi

- 24.1** Shoqëria mund të ndryshojë formën e vet ligjore nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat dhe detyrimet që shoqëria ka marrë më parë ndaj të tretëve.

Neni 25

Shpërndarja e Fitimeve

- 26.1** Pas miratimit të pasqyrave vjetore financiare dhe në rast se janë realizuar fitime, Ortaku i vetëm i shoqërisë vendos në lidhje me shpërndarjen ose jo të këtyre të fundit.

KAPITULLI V DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 26

Ligji i Zbatueshëm

- 26.1** Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Statut do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në lidhje me shoqëritë tregtare.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

MARINA BAY SHPK

Përfaqësuar nga administratori Znj. Anxhela Lulaj

Anxhela Lulaj



